

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit [“B...”] sh.pk., me seli në ..., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [F.S], avokat nga Prishtina, kundër të paditurës [“B1...”], me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [A.S] nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Ekonomike, II.EK.nr.559/2018, të datës 17.07.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.11.2019, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**HUDHET** ankesa e paditurës [“B1...”], me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike, II.EK.nr.559/2018, të datës 17.07.2019, si e **PASAFATSHME**.

### **A r s y e t i m**

Me Aktvendimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike, II.EK.nr.559/2018, të datës 17.07.2019 e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit [“B...”], me seli në ..., ku në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është konstatuar së kërkesëpadia e paditësit që neni 8.4 i kontratës për kredinë me numër ... të shpallet nul. Në pikën II të dispozitivit është detyruar pala e paditur, që për shkak të pasurimit të pa bazë juridik palës paditëse t’ia paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 19,722.22€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë dt. 12.05.2017, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin paritiv prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive. Ndërsa në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar e paditura që paditësit t ia kompensoj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1,359.20€, në afatin prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të LPK-së, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoje ankesën e të paditurës, dhe të anulojë aktgjykimin II.EK.nr.559/2018, të datës 17.07.2019, me anë të së cilës ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme**

Gjykata e Apelit me shikimin në fletë kthesën për dorëzim vërtetoi se paditësit aktgjykimin e atakuar II.EK.nr.559/2018, të datës 17.07.2019, e ka pranuar me datën 05.08.2019. Ankesa ndaj këtij aktgjykimi është pranuar në gjykatë me datë 13.08.2019, që vërtetohet nga data e vendosur në ankesë në vulën e gjykatës.

Pasi që afati për ankesë sipas dispozitës së nenit 509, pika c), të LPK-së, është 7 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit, rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej 7 ditësh, për faktin se afati fillon të llogaritet nga data 06.08.2019 dhe kur llogariten 7 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 12.08.2019. Me që paditësi ankesën e ka paraqitur me datë 13.08.2019, atëherë rezulton se ankesa është paraqitur me vonesë prej 1 ditësh.

Në bazë të nenit 186.1 të LPK-së, parashihet se ankesa e paraqitur pas afatit të parashikuar me ligj, ankesën jo të plotë, apo ankesën e palejueshme e hedh poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore. Ndërsa në bazë të nenit 186.2 të LPK-së, parashihet se ankesa është e pasafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor. Pasi që gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedh poshtë si të pasafatshme ankesën e paditësit, gjykata e shkallës së dytë në bazë të nenit 196 të LPK-së, e ka hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme, për shkak se këtë veprim nuk e ka kryer gjykata e shkallës së parë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën a) e lidhur me nenin 196, të LPK-së

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Ae.nr.320/2019, dt. 08.11.2019**

**Kryetari i Kolegjit**  
**Mahir Tutuli d.v.**  
